



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Rr "Abdi Toptani", nr.1, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al

Nr. 1113/8 Prot.

Tiranë, më 07.04.2018

V E N D I M

Nr. 25, Datë 07.04.2018

PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË "KORPORATA
ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE (KESH)" SHA, TIRANË "MBI
PËRPUTHSHMËRINË (PAJTUESHMËRISË) DHE RREGULLSHMËRINË"
Për periudhën nga data 01.04.2017 deri me datë 31.12.2017.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 10, 15, 25 dhe 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi përputhshmërinë (pajtueshmërisë) dhe rregullshmërinë" të ushtruar në Shoqërinë "Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH)" SHA për veprimtarinë nga data 01.04.2017 deri me datë 31.12.2017.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi i zbatimit të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratorit, ligjshmëria e vendimeve të marra dhe zbatimi i tyre, u konstatua që:

1.1. Gjetje nga auditimi: Këshilli Mbikëqyrës megjithëse është mbledhur dhe ka analizuar problematikat me karakter rregullator, energjetik dhe financiar të shoqërisë, në opinionin e grupit të auditimit vlerësohet se problematikat e diskutuara në këto takime dhe konkluzionet e nxjerra, nuk janë përcjellë për njohje dhe vlerësim tek Asambleja e Aksionerëve, duke mos e informuar në kohë dhe orientuar drejt organin vendim marrës në zgjidhjen e problematikave, dhe përshpejtimin e reformave të sektorit të energjisë, siç parashtrohet në Ligjin 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe ndërveprimit më të drejtë me rregullatorin.

- Këshilli Mbikëqyrës referuar situatës financiare të kësaj shoqërie që është shumë shqetësuese, me humbje në vlerën 22,240,664 mijë lekë për vitin 2014, me fitim në vlerën 797,046 mijë lekë për vitin 2015, me fitim në vlerën 1,159,337 mijë lekë për vitin 2016 dhe i pritshmi për vitin 2017 parashikohet me humbje në vlerën 1,400,000 mijë lekë deri në 6,970,601 mijë lekë, duke pasur parasysh faktin se shoqëria KESH SHA, është shoqëri tregtare që vijon të mbahet në regjim rregullimi dhe nuk operon në treg të lirë siç e parashikon Ligji 43/2015, janë sinjale shumë të forta që vazhdimi i regjimit të rregullimit për këtë shoqëri tregtare (caktimi i çmimit të shitjes së energjisë dhe i masës së detyrimit për shërbim publik) **rriskon ndjeshëm të kalojë kapitalin e shoqërisë në vlerë negative dhe shoqëria të mos jetë në gjendje të operojë (pra shkon drejt falimentimit)**, është mbledhur jo mjaftueshmërisht dhe në takime të shkurtra, gjë që vlerësohet si vlerësim jo me përgjegjësinë e duhur dhe sipërfaqësor të çështjeve të trajtuara dhe vendimeve të marra, në veçanti për problemet financiare (*Trajtuar më hollësisht në faqet 6-10, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi:

Këshilli Mbikëqyrës gjatë veprimtarisë së tij të shmangë praktikat e evidentuara me mangësi të trajtuar si më sipër dhe të zhvillojë aktivitetin e tij në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; VKM nr. 642, datë 11.10.2005, “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, i ndryshuar; Udhëzimit të Ministrisë të METE nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”; si dhe të Statutit të shoqërisë.

Në vijimësi

1.2. Gjetje nga auditimi: Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të shoqërisë është miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 12, datë 24.10.2014, disa vite më parë dhe nuk reflekton ndryshimet që janë bërë në strukturën e shoqërisë në 3 vitet e fundit, duke krijuar rrisje të brendshme lidhur me objektivat që duhet të sigurojë një sistem kontrolli i drejtë dhe efikas. Nuk ka një procedurë të shkruar referuar raportimit të gabimeve dhe rasteve të mashtrimit.

Nga Administratori i Shoqërisë, nuk është hartuar dhe paraqitur në Këshillin Mbikëqyrës, rregullorja referuar strukturës organizative, në kundërshtim me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.12, datë 20.12.2016, pika 2, e cila përcakton se: “*Administratori i shoqërisë të paraqesë për miratim në Këshillin Mbikëqyrës, ndryshimet në Rregulloren e Përgjithshme të Punës në KESH SHA, sipas ndryshimeve të kësaj strukture*” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 6-10, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi:

Administratori i Shoqërisë, të marrë masat e duhura për të bërë ndryshimin e rregullore së brendshme në përshtatje me kërkesat e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, si dhe në përputhje me strukturën organike të shoqërisë, me qëllim që të mos ketë ndryshime midis strukturave të përcaktuara sipas organikës me ato të përcaktuara në rregullore.

Brenda datës 30.06.2018

2. Nga auditimi i hartimit, shqyrtimit dhe miratimit të programit ekonomiko-financiare në organet drejtuese të shoqërisë dhe në institucionet e prore, si dhe realizimi i tij, u konstatua se:

2.1. Gjetje nga auditimi: Miratimi me vonesë i programit ekonomiko-financiar i shoqërisë. Konkretisht me shkresën me nr. 26/2 prot., datë 22.12.2017 të Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës, i është dërguar Administratorit me shumë vonesë, Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 11, datë 15.12.2017 “Për miratimin e programit ekonomiko-financiar të shoqërisë KESH SHA për vitet 2018-2022”, çka duhet ta dërgonte brenda datës 30 nëntor, veprim në kundërshtim me pikën 2 dhe 3 të nenit 3 të Udhëzimit nr. 394, datë 21.08.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare”, ku përcaktohet: “III. Afatet e hartimit, të shqyrtimit dhe miratimit të programeve të zhvillimit.

2. Drejtoritë e shoqërive, ku shteti ka mbi 50% të aksioneve, hartojnë projekt-programet dhe dërgojnë kopje të tyre, me relacion shpjegues pranë këshillave mbikëqyrës, brenda datës 1 nëntor të çdo viti.

3. Ministritë që përfaqësojnë linjën administrative të shoqërive strategjike, portet dhe shoqëritë që subvencionohen nga këto ministri, pasi i shqyrtojnë programet e zhvillimit, formulojnë qëndrimet përkatëse për treguesit kryesorë të tyre, brenda datës 30 nëntor të çdo viti”.

Referuar udhëzimit të mësipërm, MIE e ka të pamundur zbatimin e pikës 3, për shkak të vonesës së shkaktuar nga Këshilli Mbikëqyrës, për miratimin me vonesë të programit ekonomik të shoqërisë (Trajtuar më hollësisht në faqet 10-19, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi:

Këshilli Mbikëqyrës të miratojnë në kohë programin ekonomiko-financiar (buxhetin vjetor) dhe ndryshimet e tij gjatë vitit, dhe nëse është parashikuar në statut dhe ligjet specifike, të miratohet edhe nga Aksioneri i vetëm, “Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë”, si dhe të marrin masa për zbatimin rigoroz të zërave të buxhetit, si për të ardhurat dhe shpenzimet, duke bërë analiza periodike dhe nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për devijimet nga programi i miratuar.

Në vijimësi

3. Nga auditimi i zbatimit të strukturës organizative, dhënies së pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, u konstatua që:

3.1. Gjetje nga auditimi: Këshilli Mbikëqyrës me vendim nr. 10, datë 15.12.2017, ka miratuar dhënien e shpërblimit financiar për punonjësit e Shoqërisë KESH SHA në vlerën totale prej **45,506,995 lekë**, para daljes së rezultatit financiar, veprim në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika 1/b dhe pika 2. Ky veprim ngarkon me përgjegjësi anëtarët e këshillit mbikëqyrës të cilët kanë firmosur vendimin: E.Gj, E.Ç, A.K, A.M dhe E. K, referuar

Ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 163, pika 3 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 19-23, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi:

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të merren masa që shpërblimet për punonjësit në fund të vitit, të jepen sipas kriteve të përcaktuara në Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, dhe vetëm pas daljes dhe miratimit të rezultatit ekonomiko-financiar të shoqërisë me fitim dhe të miratuar nga Aksioneri i vetëm, **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë**.

Në vijimësi

4. Nga auditimi i mbajtjes së evidencës kontabile në qendër dhe në njësitë e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit, u konstatua që:

4.1. Gjetje nga auditimi: Pavarësisht angazhimit të kësaj shoqërie për optimizimin e shpenzimeve dhe rritjen e të ardhurave, përsëri kjo shoqëri mbetet në situatë të vështirë financiare për shkak të natyrës ligjore dhe rregullatore, jashtë kontrollit të shoqërisë, ku me kryesorët janë: i) mos trajtimi i borxheve të mëdha të akumuluar në funksionin e Furnizuesit Publik me Shumicë, ii) mos caktimi i një çmimi të arsyetuar shitje energjie që reflektojë/mbulojë kostot e operimit dhe veprimtarisë statutoare dhe ligjore të kësaj shoqërie, iii) ngadalësimin të zbatimit të reformave të sektorit në frymën e parashikimeve të Ligjit nr. 43/2015, pra është vonuar derregullimi i veprimtarisë së kësaj shoqërie dhe iv), si dhe ngarkimit të pajustificuar me detyrim për shërbim publik dhe përtej mundësive të shoqërisë. Konkretisht për vitin 2014 shoqëria ka rezultuar me humbje në vlerën 22,240,664 mijë lekë (si rrjedhojë e zbatimit të vendimeve të Asamblesë së Aksionerëve nr. 5569/1 datë 24/07/2014 për provizionin e borxheve të trashëguara nga ndarja e OSSH deri në vitin 2006), për vitin 2015 me fitim në vlerën 797,046 mijë lekë (apo 4% e xhiros, si rezultat i një administrimi të përmirësuar dhe viti hidrik me i mirë se mesatarja shumëvjeçare), për vitin 2016 me fitim në vlerën 1,159,337 mijë lekë (apo 6% e xhiros, administrim i përmirësuar dhe viti hidrik më i mirë se mesatarja shumëvjeçare), dhe i pritshmi për vitin 2017 parashikohet me humbje në vlerën 1,400,000 mijë lekë deri në 6,970,601 mijë lekë (për shkak të situatës së vështirë hidrike), detyrim i pajustificuar për shërbim publik dhe çmim shitje që nuk mbulon kostot e operimit), referuar bilancit menaxherial të shoqërisë, jo atij tatimor, situata financiare e kësaj shoqërie është jo vetëm shumë shqetësuese, por kapitali i saj riskon të kalojë në vlerë negative, pra të falimentojë (në rastin me të mirë falimentim i provokuar operacional) si rrjedhojë veprimeve dhe mosveprimeve të organeve drejtuese dhe monitoruese të saj (ERE, MIE, Ministria e Financave, Këshilli Mbikëqyrës dhe KM) (*Trajtuar më hollësisht në faqet 28-40, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi:

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Asambleja e Aksionerëve të analizohet situata ekonomiko-financiare e shoqërisë, dhe të merren masat të menjëhershme, që kjo shoqëri të mund të operojë dhe kryejë veprimtarinë e sajë si një shoqëri publike shtetërore shumë e rëndësishme për ekonominë kombëtare.

Menjëherë

4.2. Gjetje nga auditimi: Për përdorimin e programit të kontabilitetit “Alfa” nga nëpunësit e financës, në rregulloren e brendshme nuk janë përcaktuar personat që kanë të drejtë të përdorin sistemin si dhe nivelet e aksesit për këto persona (*Trajtuar më hollësisht në faqet 28-40, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi:

Nga administratori i shoqërisë KESH SHA, për rritur shkallën e sigurisë të hedhjes dhe ruajtjes të dhënave të kontabilitetit në sistem, të autorizohen personat në varësi të proceseve dhe operacioneve të punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.3. Gjetje nga auditimi: Në vitin 2004, me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 122, datë 04.03.2004, është miratuar për herë të parë në zbatim të Ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kanë kaluar në përgjegjësi Administrimi Shoqërisë “KESH” SHA. Pronat kanë pësuar ndryshime ndër vite, si rezultat i privatizimeve, krijimit të shoqërive (OST SHA dhe OSSHE SHA). Nga shoqëria janë bërë grupime të pasurive në teren, vlerësime etj, por nuk ka një rakordim bindës ndërmjet regjistrimit të kontabilitetit me formularët që kanë shoqëruar vendimet e Këshillit të Ministrave. Ka ndryshime emërtesash të pronave me kontabilitetin. Grupet e terenit nuk kanë marrë fillimisht të dhënat e kontabilitetit. Duke krahasuar formularët që kanë shoqëruar VKM, u konstatua se:

Në Hec Fierzë, nuk evidentohet saktësisht i regjistruar në kontabilitet sipas analizës, Ish-Godina e Kinezëve zona “B”, me sipërfaqe totale të pronës 1600 m² dhe ndërtesë 600 m²;

Në Hec Vau Dejës, nuk evidentohet saktësisht i regjistruar “Oficinë lagjia Skëndërbeg”, me sipërfaqe totale 300 m² dhe 150 m² ndërtesë (sipas emërtesës);

Në Hec Ulëz, objekti i shitur, nuk janë mbartur në kontabilitet dy fjetina punëtorësh dhe nuk u gjet mbartje dhe shkarkimi nga kontabiliteti.

Në kontabilitet në zërin “Toka”, ka pozicion financiar në vlerën 1,394,836,837 lekë. Në kontabilitet trojet në shumicën e rasteve janë emërtuar tokë.

Për disa pasuri të paluajtshme shoqëria nuk është e pajisur me certifikatë pronësie, nuk ka një plan rievimi të plotë (hartë), nëpërmjet së cilës të evidentohen me numrat përkatës, pasuritë e paluajtshme asete të shoqërisë. Mungesa e regjistrimeve në kontabilitet, apo shkarkimi nga kontabiliteti (pa i regjistruar më parë), kanë ndikim sipas rastit në vlerën e kapitalit (*Trajtuar më hollësisht në faqet 28-40, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi:

- Nga Shoqëria “Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) SHA, Tiranë të ngrihen grupe pune për verifikimin e pasurive sipas formularëve që kanë shoqëruar vendimet respektive të Këshillit Ministrave, për zvogëlimet e kapitalit, duke i krahasuar me regjistrimet dhe shkarkimet nga kontabiliteti.

- Të zbatohen procedurat ligjore, për të regjistruar në Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, të gjitha objektet që janë regjistruar në “Zërin troje” në kontabilitet.

Brenda datës 30.11.2018

4.4. Gjetje nga auditimi:

-Shoqëria “KESH” Sh.a nuk ka arritur të finalizojë rakordimin e detyrimeve të ndërsjellta me Shoqërinë “OSHEE” Sh.a, Shoqërinë “OST” Sh.a dhe Etj, në kundërshtim me urdhrin e Kryeministrit nr. 74, datë 27.05.2015 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për evidentimin dhe adresimin e problematikave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe

parandalimin e krijimit të detyrimeve të reja në sektorin e energjisë elektrike”. Në mënyrë detajuar pasqyra si më poshtë vijon:

Nr.	Debitorë ndaj KESH	000/lekë	Kreditorë ndaj KESH, 000/lekë	
1	OST Kredi afat gjatë	10,880,593	Afat Gjatë	49,093,302
2	Kredi Afat shkurtër OST	3,862,977	Afat shkurtër	14,298,144
3	OSHEE K/Afat shkurtër	3,811,780	O.D. Bankat e niv. II	33,921,776
4	OSHEE Fatura	50,240,191	Furnitorë	2,558,269
	2+3+4 Totali detyrim	57,914,948	Tatime	3,419,445
			Paga Dhjetor	37,085
			Sigurime	29,132
			Totali	54,263,851

Burimi i të dhënave KESH SHA

Referuar të dhënave të paraqitur në tabelën e mësipërme, shoqërisë i kanë borxhe në vlerën 57,914,948 mijë lekë. Vetë Shoqëria ka borxhe ndaj të tretëve në vlerën 54,263,851 mijë lekë. Pra shoqërisë në balancë i detyrohen të tretët në vlerën 3,651,097 mijë lekë (57,914,948 mijë lekë minus 54,263,851 mijë lekë) (Trajtuar më hollësisht në faqet 28-40, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi:

Nga Shoqëria “KESH” SHA të merren masa për përfundimin e rakordimeve të detyrime të ndërsjellta me Shoqërinë “OSHEE” SHA, Shoqërinë “OST” SHA etj.

Brenda datës 30.09.2018

5. Nga auditimi i zbatimit të ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave, u konstatua që:

5.1. Gjetje nga auditimi:

-Në 8 raste, studimi i vlerës së kontratës është llogaritur duke u mbështetur në studimin e tregut dhe sigurimin e ofertave për të njohur nivelin aktual të tregut, por nuk është dokumentuar nëse nga Autoriteti Kontraktor, janë kryer analizat e kostos së mallrave që do të prokurohen, duke krahasuar elementet e mësipërm me specifikimet teknike, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”.

-Për 15 procedura prokurimi, në hartimin e dokumenteve të tenderit, nuk janë dhënë argumentime mbi vendosjen e çdo kriteri të veçantë për kualifikim. Ky veprim bie në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

- Në 9 procedura prokurimi, specifikimet teknike nuk janë hartuar plotësisht në përputhje me nenin 23 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi ato nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë marke apo emri të veçantë, patente, vizatimi ose tipi, origjinë specifike, prodhuesi ose sipërmarrje shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

-Në 8 procedura prokurimi, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, Ligjin 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” nenet 108-118, çka ngarkon me përgjegjësi komisionet e vlerësimit të ofertave.

-Në 12 raste, anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, është kryer pa analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për shkaqet subjektive që vërehen në procedurat e anuluar, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 24 dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, neni 73, pika 2. Arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë mjaftueshmërisht bindëse dhe duhet tu komunikohen të gjithë pjesëmarrësve në procedurën e prokurimit. Autoriteti kontraktor publikon njoftimin për anulimin e procedurës së prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç është publikuar njoftimi i kontratës, jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së vendimit për anulim.

-Në 3 raste për vlerën 89,937 mijë lekë, zbatimi i kontratave për mallra, shërbime dhe punë publike, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 60, pika 1, e cila përcakton se: “1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese” (Trajtuar më hollësisht në faqet 40-115, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi:

Për rritjen e efikasitetit në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kriterëve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, duke siguruar që Autoriteti Kontraktor të pranojë oferta të cilat janë të përballueshme, të qëndrueshme, të pakushtëzuara dhe të plotësimit të nevojave të saj:

-Nga zyra, ose personat e ngarkuar nga Administratori i Shoqërisë, përllogaritja e vlerës së kontratës, të bëhet duke analizuar koston e mallrave që do të prokurohen, si dhe duke harmonizuar metodat dhe alternativat e përllogaritjes së vlerës limit të kontratës, në raport me specifikimet teknike.

-Autoriteti Kontraktor, në vijim duhet të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim, që të sigurojë konkurrencën e nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punëve civile, për të arritur rezultate të dëshirueshme në efektivitetin e përdorimit të fondeve. Këto kërkesa duhet të kenë në konsideratë edhe faktin që të kushtëzojnë kualifikimin e operatorëve në vartësi të shlyerjes/ose jo të detyrimeve financiare ndaj KESH, zgjidhjes së njëanshme të kontratave, ose mos përmbushjes të të gjitha detyrimeve kontraktore. Ky rekomandim mbështetet në frymën e Ligjit për prokurimin publik, si dhe në rregullat e prokurimit publik.

-Nga shoqëria t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ i operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi në disa raste konstatohet jo korrekt.

-Komisioni i vlerësimit të ofertave të vlerësojë drejtë kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike të miratuara në dokumentet e tenderit, duke u mbështetur në dokumente zyrtare dhe fletë analiza të lëshuara nga organet kompetente.

-Anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, të kryhet duke analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për arsyet e procedurave të anuluar, në zbatim të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar. Arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë mjaftueshmërisht bindëse dhe duhet tu komunikohen të gjithë pjesëmarrësve në procedurën e prokurimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.2. Gjetje nga auditimi: Procedura e prokurimit për shërbime konsulente hartim projekt preventivi për kontratën "Pastrim i zonës para rrjetave metalike tek vepra e marrjes në kuotë 222 mnnd dhe rrjetave të punës tek seksionet e tubacioneve të agregatit nr. 4 HEC Fierzë", është zhvilluar në Njësinë HEC Fierzë. Termat e referencës janë përgatitur nga grupi i punës referuar shkresës nr. 343 prot., datë 11.05.2016.

Delegimi për zhvillimin e procedurës së prokurimit për HEC Fierzë është bërë me shkresë nr. 4571/2, datë 06.06.2016.

Rezulton se sasi të orëve të punës për mekanizma për realizimin e pastrimit të dherave të përshkruara në preventivin e punimeve kanë mangësi të theksuara. Nëse merret në konsideratë maksimumi i mundshëm, për punime gjatë 24 orëve, rezulton se dherat e pastruara në sasinë 3270 m³ janë realizuar duke pastruar 1.9 m³ në orë. Nga verifikimi i preventivit dhe analizave të çmimeve rezulton se për pastrimin e 1 m³ dhera është parashikuar përdorimi i pontonit dhe makinerive në masën 67 orë për 1 m³, pra pa asnjë argumentim dhe pa asnjë justifikim. Nëse do të nevojitej përdorimi i pontoneve dhe makinerive (greifer) për 67 orë për pastrimin e 1 m³ dhera, kontrata do të zgjaste për më shumë se 30 vjet. Rritja artificiale e çmimeve për njësi ka rritur ndjeshëm vlerën e fondit limit. Disa zëra punimesh, referuar kohës së parashikuar nga projektuesi për përfundimin e kontratës dhe kohës së nevojitur në fakt për realizimin e gërmimit, i paraqesim si më poshtë:

Për zërin e punimeve "Pastrim dhe heqje materiale të ngurta (gurë dhe zhavorre me dimensione më të mëdha se 40 mm)", nga përllogaritjet rezulton se çmimi duhet të ishte jo 76,800 lekë/m³ por 2,133 lekë/m³.

Vetëm sipas këtij zëri punimi, vlera e fondit limit është rritur artificialisht në shumën 205,334,250 lekë [2750 m³ x (76,800 lekë/m³-2,133 lekë/m³)].

Për zërin e punimeve "Pastrim dhe heqje materiale inerte të imëta (llum dhe dhera me dimensione me të vogla se 40 mm), me pompë thithëse" nga përllogaritjet rezulton se çmimi duhet të ishte jo 78,300 lekë/m³ por 2,145.3 lekë/m³.

Sipas këtij zëri punimi, vlera e fondit limit është rritur artificialisht në shumën 24,369,504 lekë [320 m³ x (78,300 lekë/m³-2,145.3 lekë/m³)].

Për dy zërat e mësipërme të punimeve, fondi limit është rritur me vlerë 229,703,754 lekë (205,334,250 lekë + 24,369,504 lekë).

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 19.10.1998 "Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit", neni 5, ku përcaktohet: "... Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në kreun II të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit", si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit" (Trajtuar më hollësisht në faqet 40-115, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi:

KESH SHA, të marrë masa për zhvillimin e procedurave të prokurimit për shërbime konsulente në drejtorinë qendrore dhe të angazhojë specialistë të fushës me kualifikime të larta profesionale, në mënyrë që të shmangen abuzimet në përcaktimin e vlerave paraprake të përllogaritura për punimet që do të realizohen. Të bëhen analizat e duhura për këtë rast dhe të tregohet kujdesi i duhur edhe për kontrata në të ardhmen edhe për njësitë e tjera, në mënyrë që lidhen dhe të zbatohen kontrata në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe objektivitetit.

Në vijimësi

6. Nga auditimi mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, u konstatua që:

6.1. Gjetje nga auditimi: Në asnjë rast nuk është trajtuar risku i kalimit të shoqërisë në kapital negativ, ardhur si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të ERE, MIE, Këshillit Mbikëqyrës, MF, si dhe të disa strukturave të administratës të shoqërisë. Grupi i auditimit, në opinionin e vet e konsideron këtë çështje si një situatë me shumë risk për KESH SHA, çka do të sillte përballjen e shoqërisë me alternativat e zvogëlimit të kapitalit, riorganizimin në një formë tjetër të shoqërisë ose prishjen e saj, referuar nenit 136 pika 3, nenit neni 154 pika 2 të Ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, dhe nenit 104 të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nga auditimi i regjistrit të riskut të KESH SHA, u konstatua se mungon një trajtim specifik për këtë risk apo problematikë, i cili është jetik për shoqërinë. Gjithashtu mungojnë trajtime të risqeve të detyrimeve, kryesisht në lidhje me kreditë e marra nga ana e KESH SHA. Mbingarkimi me kredi vazhdon të rëndojë akoma më shumë situatën ekonomike të shoqërisë, duke provokuar një borxh tej mundësive ekonomike të saj. Në këto kushte, në opinion të grupit të auditimit, KESH SHA në një të ardhme jo të largët është i riskuar për vendosje sekuestro të llogarive të saj (*Trajtuar më hollësisht në faqet 115-122, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi:

-Nga ana e Shoqërisë të kërkohet kryerja e trajnimeve në Ministrinë e Financave për kuptimin dhe implementimin e sistemeve të kontrollit dhe menaxhimit financiar. Gjithashtu të merren masa për hartimin e një rregullore të re për përcaktimin e saktë të detyrave sipas strukturës së miratuar dhe përcaktimin e marrëdhënieve ndërmjet pozicioneve të punës për çështje të raportimit, delegimit dhe përgjegjësisë, si dhe të regjistrit të riskut e strategjisë së njësisë.

-Nga ana e auditimit të brendshëm të kryhen angazhime të auditimit në përputhje me manualin e auditimit të brendshëm, duke vlerësuar paraprakisht riskun e brendshëm dhe të ofrohet siguri në auditimin e zonave më me risk sipas këtij vlerësimi.

Në vijimësi

7. Nga auditimi mbi zbatimin rregullave dhe procedurave të shitje-blerjes të energjisë elektrike, u konstatua që:

7.1. Gjetje nga auditimi: Marrëveshja me Shoqërinë “OST” e miratuar me vendimin e Bordit të ERE Nr.79/2016, për shërbimet ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektroenergjetik ka dëmtuar buxhetin e Shoqërisë "KESH" SHA dhe Buxhetin e Shtetit në vlerën **1,204,546,019 lekë ose 9,029,580 euro**.

Për pos sa mësipër, grupi i auditimit ka arritur në konkluzionin e përgjithshëm se:

Bilanci energjik i Shoqërisë “KESH” SHA për vitin 2016 dhe 2017, është i pa rakorduar me transaksionet financiare energjetike respektivisht për sasi të 87,704 MWh dhe 189,626 MWh.

Në opinionin tonë: Mos mbyllja e bilancit energjetik (mos rakordim i transaksioneve), do të thotë se faturat e hartuara nga OST SHA, për shërbimin e balancimit nuk reflektojnë sasinë e energjisë së injektuar në kuadër të ofrimit të këtij shërbimi.

Për sa trajtuar më sipër, në mungesë të mos mbylljes së bilancit energjetik për vitin 2016 dhe 2017 nga Shoqëria "KESH" SHA, si rrjedhojë e veprimeve dhe mos veprimeve të OST, ERE, MEI, si dhe efekteve që ndonjë korrigjim i mundshëm mund të ketë sjell në mbylljen/ose jo të pasqyrave financiare të konsoliduara të vitit 2016 dhe të pritshmit 2017, grupi i auditimit nuk ka qenë në gjendje të sigurojë të dhëna (evidencë) auditimi të mjaftueshme dhe të

përshtatshme auditimi për shkak të pasigurisë të shifrave dhe të kufizimit (nuk ka evidencë të marrë "Verifikuar" në OSHEE dhe OST, pra grupi i auditimit nuk është duke audituar pasqyrat financiare OSHEE dhe OST), bazuar në dhënien e një opinionit pavarësisht vlerës 1,204,546,019 lekë ose 9,029,580 euro të pasqyruar si mësipër, pra grupi i auditimit ka refuzuar dhënien e opinionit, në lidhje me këtë çështje.

Shkaku: Në opinionin tonë, përveç sa më sipër, ERE me veprimet dhe mosveprimet e saj, ka krijuar problematikë serioze në zbatim të Ligjit 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe VKM nr. 244 datë 30.03.2016 "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik", i ndryshuar, duke dëmtuar në këtë mënyrë interesat e ligjshme të shoqërisë "KESH" SHA, si dhe të Shtetit, pasi me vendimet e saj të deritanishme "Për miratimin e rregullave të tregut", paraqet paqartësi dhe madje konflikt të vetë dispozitave të rregullave të tregut, të cilat nuk janë hartuar në frymën e Ligjit nr.43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe nuk janë përshtatur me periudhën tranzitore, e cila do të sillte kalimin normal në rregullat përfundimtare miratuar sipas modelit të tregut, duke u shfaqur si rregulla në zbatim të parashikimeve të Ligjit të vjetër. Konkretisht: Vendimi i ERE nr.111 datë 01.07.2016 "Mbi lënien në fuqi të Vendimeve nr.139, nr.141, nr.145, nr.146, nr.147, nr.148, datë 26.12.2014, Vendimi i ERE nr.136, datë 15.08.2016 "Për miratimin e kontratës TIP për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga Shteti/KESH SHA dhe furnizuesit e shërbimit universal OSHEE SHA për periudhën 01.07.2016-31.12.2016.

Edhe pse, përveç detyrimit ligjor në rrolin e monitoruesit të shoqërive publike të tregut të energjisë, ERE ka përfituar nga Shoqëria "KESH" për periudhën viti 2014-2016, vlerën 101,406,642 lekë, në zbatim të tarifave rregullatore të vendosura çdo vit nga vetë (*Trajtuar më hollësisht në faqet 122-189, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi:

Nga Administratori i Shoqërisë të prezantohet në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë mos rakordimi i bilancit për transaksionet financiare energjetike për vitin 2016 dhe 2017 respektivisht në sasinë 87,704 MWh dhe 189,626 MWh, si dhe efekteve që ndonjë korigjim i mundshëm mund të ketë sjellë në mbylljen/ose jo të pasqyrave financiare të konsoliduara të vitit 2016 dhe të prithshmit 2017, duke i kërkuar të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një Grupi teknik me specialistë të fushës, i cili të kryejë ekzaminimet teknike duke respektuar kërkesën e materialitetit dhe të paraqitjes së sqartë dhe të vërtetë të transaksioneve energjetike në shoqëritë OSHEE, OST dhe KESH, me synim rakordimin e bilancit për transaksionet financiare energjetike për vitin 2016 dhe 2017.

Brenda datës 31.05.2018

8. Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm, u konstatua që:

8.1 Gjetje nga auditimi: KLSH me shkresën nr. 689/9 prot, datë 29.10.2017, protokolluar nga "KESH" me nr. 3420/80 prot, datë 04.01.2018, i ka dërguar Shoqërisë "Korporata Elektroenergjitike Shqiptare", Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet. Këshilli Mbikëqyrës me vendim nr. 1, datë 23.02.2018, ka miratuar planin e veprimit për realizimin e rekomandimeve, duke ngarkuar administratorin e shoqërisë për zbatimin e tyre. Pra zbatimi i rekomandimeve nga kjo shoqëri është në proces, për arsye të periudhës mjaft të shkurtër, grupi i auditimit nuk verifikoi zbatimin e rekomandimeve, gjë e cila do të bëhet nga KLSH në një moment të dytë. Nisur nga eksperiencia e zbatimit të rekomandimeve nga kjo shoqëri, konstatohet se rekomandimet nuk janë zbatuar plotësisht. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 6-6, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi:

Nga Shoqëria "KESH" SHA të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, të cilat nga auditimet kanë rezultuar të pazbatuara, si dhe të ndiqen me vëmendje të posaçme ato të cilat janë në procese gjyqësore.

Menjëherë dhe në vijimësi

B.1 MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Pastrimi i zonës para rrjetave metalike tek vepra e marrjes me kuotë 222.0 MMND dhe rrjetave të punës tek seksionet e tubacioneve të ajrit në HEC Fierzë", viti 2017, u konstatua se janë rritur në mënyrë të paargumentuar dhe të pabazuar ligjërisht shpenzimet në fazën e hartimit të preventivit dhe të zbatimit të kësaj kontrate, për:

- Faza parë, zëri 1, investigim i gjendjes ekzistuese dhe përgatitja e dokumentacionit teknik në vlerën 6,500,000 lekë.

- Faza e parë, zëri 2, përgatitja, kontrolli dhe furnizimi i mjeteve lundruese të tipit pontoom, pajisjeve dhe makinerive të nevojshme për heqjen e materialeve duke përfshirë edhe pompat, motorin, pajisjet elektromekanike të nevojshme, agregatët etj, në vlerën 15,250,000 lekë.

- Faza e parë, zëri 3, përgatitja, kontrolli dhe furnizimi i mjeteve lundruese të tipit pontoom, pajisjeve dhe makinerive të nevojshme për largimin e materialeve tek vepra e marrjes të gatshme për transport, duke përfshirë dhe kontenjerin përkatës në vlerën 6,500,000 lekë.

- Faza e parë, zëri 4, përgatitja, kontrolli dhe furnizimi i pajisjes kapëse e tipit greifer dhe pompë thithëse që do të përdoren për heqjen e materialeve të ngurta, në vlerën 3,740,000 lekë.

- Faza e parë, zëri 5, përgatitja, kontrolli dhe furnizimi i pajisjeve dhe sistemit elektronik të kontrollit të punimeve gjatë heqjes së materialeve të ngurta, në vlerën 1,650,000 lekë.

- Faza pestë, zëri 5, përgatitja dhe dokumentacioni teknik të objektit dhe raportimi final në vlerën 2,200,000 lekë. Shuma 35,840,000 lekë x 1.2 (TVSH) = 43,008,000 lekë.

Vlera totale **43,008,000** lekë, është pjesë integrale e zërave të tjerë të punimeve të kësaj kontrate, duke rënduar padrejtësisht koston e investimit.

Veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit", neni 59 "Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës", VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".

Për veprimin e mësipërm, është shkelur koncepti i "Bëgatimit pa shkak", i ardhur si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të shoqërisë projektuese "C", me përfitues padrejtësisht bashkimin e operatorëve "S" në vlerën **43,008,000 lekë** referuar Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 655 "Bëgatimit pa shkak", ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: "*Personi që, pa shkak të ligjshëm, ka fituar ose ka kursyer diçka në dëm të një personi tjetër, detyrohet të shpërblejë këtë të fundit për humbjet pasurore që ka pësuar, brenda caqeve të bëgatimit*".

Për pasojë vlera 43,008,000 lekë përbën dëm ekonomik për Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare dhe Buxhetin e Shtetit (*Trajtuar më hollësisht në faqet 40-115, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimin, arkëtimi i **vlerës 43,008,000 lekë**, nga "S" dhe shoqëria projektuese "C", për shkeljet konstatuara në kontratën me objekt "Pastrimi i zonës para rrjetave metalike tek vepra e marrjes me kuotë 222.0 MMND dhe rrjetave të punës tek seksionet e tubacioneve të ajrit në HEC Fierzë", viti 2017, për arsye se janë rritur në mënyrë të paargumentuar dhe të pabazuar ligjërisht shpenzimet në fazën e hartimit të preventivit dhe

të zbatimit të kësaj kontrate, duke rënduar padrejtësisht koston e investimit në vlerën **43,008,000** lekë, vlerë e cila për Shoqërinë “Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare” dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**. Dëmshtëpërblimi mbështet në Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 655 dhe neni 32.

Brenda datës 30.06.2018

2. Gjetje nga auditimi: Marrëveshja me Shoqërinë “OST” e miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 79/2016, për shërbimet ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektroenergjetik ka dëmtuar buxhetin e Shoqërisë "KESH" SHA dhe Buxhetin e Shtetit në vlerën **1,204,546,019 lekë ose 9,029,580 euro**.

Për posë sa më sipër, grupi i auditimit ka arritur në konkluzionin e përgjithshëm se:

Bilanci energjik i Shoqërisë “KESH” SHA për vitin 2016 dhe 2017, është i pa rakorduar me transaksionet financiare energjetike respektivisht për sasitë 87,704 MWh dhe 189,626 MWh.

Në opinionin tonë: Mos mbyllja e bilancit energjetik (mos rakordim i transaksioneve), do të thotë se faturat e hartuara nga OST SHA, për shërbimin e balancimit nuk reflektojnë sasinë e energjisë së injektuar në kuadër të ofrimit të këtij shërbimi.

Për sa trajtuar më sipër, në mungesë të mos mbylljes së bilancit energjetik për vitin 2016 dhe 2017 nga Shoqëria "KESH" SHA, si rrjedhojë e veprimeve dhe mos veprimeve të OST, ERE, MEI, si dhe efekteve që ndonjë korrigjim i mundshëm mund të ketë sjell në mbylljen/ose jo të pasqyrave financiare të konsoliduara të vitit 2016 dhe të pritshmit 2017, grupi i auditimit nuk ka qenë në gjendje të sigurojë të dhëna (evidencë) auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme auditimi për shkak të pasigurisë të shifrave dhe të kufizimit (nuk ka evidencë të marrë "Verifikuar" në OSHEE dhe OST, pra grupi i auditimit nuk është duke audituar pasqyrat financiare OSHEE dhe OST), bazuar në dhënien e një opinionit pavarësisht vlerës 1,204,546,019 lekë ose 9,029,580 euro të pasqyruar si më sipër, pra grupi i auditimit ka refuzuar dhënien e opinionit, në lidhje me këtë çështje.

Shkaku: Në opinionin tonë, përveç sa më sipër, ERE me veprimet dhe mosveprimet e saj, ka krijuar problematikë serioze në zbatim të Ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe VKM nr. 244 datë 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik”, i ndryshuar, duke dëmtuar në këtë mënyrë interesat e ligjshme të shoqërisë “KESH” SHA, si dhe të Shtetit, pasi me vendimet e saj të deritanishme “Për miratimin e rregullave të tregut”, paraqet paqartësi dhe madje konflikt të vetë dispozitave të rregullave të tregut, të cilat nuk janë hartuar në frymën e Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nuk janë përshtatur me periudhën tranzitore, e cila do të sillte kalimin normal në rregullat përfundimtare miratuar sipas modelit të tregut, duke u shfaqur si rregulla në zbatim të parashikimeve të Ligjit të vjetër. Konkretisht: Vendimi i ERE nr.111 datë 01.07.2016 “Mbi lënien në fuqi të Vendimeve nr.139, nr.141, nr.145, nr.146, nr.147, nr.148, datë 26.12.2014, Vendimi i ERE nr.136, datë 15.08.2016 “Për miratimin e kontratës TIP për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga Shteti/KESH SHA dhe furnizuesit e shërbimit universal OSHEE SHA për periudhën 01.07.2016-31.12.2016.

Edhe pse, përveç detyrimit ligjor në rolin e monitoruesit të shoqërive publike të tregut të energjisë, ERE ka përfituar nga Shoqëria “KESH” për periudhën viti 2014-2016, vlerën 101,406, 642 lekë, në zbatim të tarifave rregullatore të vendosura çdo vit nga vetë ajo (Trajtuar më hollësisht në faqet 122-189, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi:

Nga Administratori i Shoqërisë të prezantohet në organet drejtuese **vlera 1,204,546,019 lekë ose 9,029,580 euro**, që ka të bëjë me zbatimin e marrëveshjes të lidhur ndërmjet “KESH” SHA dhe “OST” SHA e miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 79/2016, për shërbimet

ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektroenergjetik, vlerë e cila **përbën dëm ekonomik** për buxhetin e Shoqërisë "KESH" SHA dhe Buxhetin e Shtetit.

Brenda datës 30.06.2018

3. Gjetje nga auditimi: Gjatë zbatimit të kontratës "Pastrim i zonës para rrjetave metalike tek vepra e marrjes në kuotë 222 mnnd dhe rrjetave të punës tek seksionet e tubacioneve të agregatit nr. 4 HEC Fierzë", në situacionin përfundimtar është rritur volumi i dherave të pastruar, ndërkohë që gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës theksohet se volumi i punimeve është kryer në përputhje me vijën e prerjevesiç tregohet në vizatime dhe thellësinë e dhënë në projekt. Po ashtu në raportet progresive, të hartuara gjatë zbatimit të kontratës është theksuar se: *"Të gjitha punimet janë matur për t'u hedhur në librin e masave"*. Këto procesverbale janë nënshkruar nga kontraktori dhe mbikëqyrësi i punimeve dhe kanë të bëjnë me të gjithë periudhën e gërmimit.

- Në pikën 2 të raportit teknik përcaktohet: *"...Në përgjithësi, të dhënat e projektit përputheshin me atë çfarë u konstatua në terren"*.

Bazuar në sa më sipër, fondi rezervë është kërkuar të shfrytëzohet edhe pse është deklaruar se volumet nuk kanë ndryshuar. Në dokumentacionin teknik të dosjes nuk rezulton asnjë dokumentacion që vërteton matjen e volumit të gërmimeve në vend depozitim, skica apo matje të tjera, madje kërkesa për shfrytëzimin e fondit rezervë është bërë me datë 10.11.2017, ndërkohë që bazuar në procesverbalin e përfundimit të kësaj faze (faza e tretë), pastrimi i dherave ka përfunduar me datë 07.11.2017.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me specifikimet teknike pika 1.3 "Dokumentet dhe vizatimet" ku përcaktohet:

"Të gjitha vizatimet dhe dokumentet e tjera teknike që shoqërojnë këtë projekt do të jenë bazë për vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së punës që do të bëhet për zbatimin e këtij projekti.

Kontraktori do të shqyrtojë projektin që në fillim të punës dhe përpara lidhjes së kontratës me investitorin e objektit. Kontraktori do të verifikojë të gjitha sasisë, përmasat, të dhënat teknike dhe detajet e dhëna në vizatimet dhe dokumentet teknike që shoqërojnë këtë projekt. **Kontraktori do të marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë në kryerjen e llogaritjeve për sasinë dhe llojet e materialeve, volumeve të punës dhe pajisjeve të kërkuara për kryerjen e kësaj pune"**.

Në procesverbalin e datës 07.11.2017 "Përfundimi i fazës së tretë" mbajtur nga përfaqësuesit e kontraktorit O P, A. Gj dhe G. P dhe Mbikëqyrësi i punimeve A. J theksohet: *"Pastrimi i zonës përpara rrjetave është kontrolluar ecuria me anë të matjeve periodike me aparaturën tip Sonar, në mënyrë që procesi i pastrimit të zbatohet sipas kërkesave të projektit"*.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin se shtesa e volumeve është e pa argumentuar dhe e pa justifikuar, si dhe vlera 17,123,256 lekë është përfituar padrejtësisht nga kontraktorët "S" dhe përbën dëm ekonomik.

Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me specifikimet teknike të kontratës pika 1.3.

-Në Specifikimet teknike pika 1.6 paragraf 11, përcaktohet: *"Në grafikun dhe zbërthimin e metodologjisë së punës duhet të përfshihen të paktën këto aktivitete:*

-Bazuar në dokumentet e tenderit, kontraktori ka paraqitur për kryerjen e punimeve mjet lundrues "M/N Pontone "D"". Në këtë mjet do të instalohej sistemi i pompave, grejferi dhe sistemi i kontrollit elektronik të punimeve. Në fakt nga ana e kontraktorit është sjellë vetëm një platformë mbajtëse, në të cilën është vendosur një ekskavator Liebherr 832 me grejfer. Në këtë platformë nuk është vendosur sistemi i pompimit për thithjen e materialeve të imëta. Nga ana e kontraktorit nuk është përcaktuar origjina e mjeteve të sjella në terren, po ashtu në dosjen teknike nuk ka dokumentacion mbi pronësinë e tyre, apo dokumentacionin ligjor për përdorimin e tyre.

-Në raportin teknik theksohet: "Vinçi ekskavator është i pajisur me sistem pompimi për thithjen e llumrave me diametër më të vogël se 40 mm". Nga verifikimi i përbërjes së këtij lloj mekanizmi si nëpërmjet fotove, ashtu edhe dokumentacionit tjetër në dosjen teknike rezulton se **nuk disponohet pompë për thithjen e llumrave** dhe si rezultat procesi i punës sipas zërit "Heqja e materialeve inerte të imëta (llumra dhe gurë të vegjël < 40 mm", ose volumi 320 m³ nuk është realizuar. Nga verifikimi në vend depozitimin e hedhjes së dherave nuk u konstatuan dhera me dimensione të imëta, megjithëse aty po punohet për realizimin e një kontrate tjetër.

Sa më sipër nga ana e kontraktorit është përfitur padrejtësisht vlera 22,944,000 lekë (320 m³ x 59,750 lekë/m³ + TVSH), vlerë e cila përbën dëm ekonomik. Po ashtu, nga ana e kontraktorit është përfitur padrejtësisht transport për këtë zë punimi me vlerë 1,512,000 lekë (280 m³ x 4,500 lekë/m³ + TVSH).

Për dy zërat e mësipërm (pastrim materiale të imëta dhe transporti përkatës), nga ana e kontraktorit (bashkimit të OE) "S", është përfitur padrejtësisht vlera 24,456,000 lekë (22,944,000 lekë + 1,512,000 lekë), vlerë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë.

Në total, për këtë kontratë, nga ana e kontraktorit "S", është **përfitur padrejtësisht vlera 41,579,256 lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqet 40-115, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi:

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 41,579,256 lekë**, nga kontraktori "S", për punime të likuiduara por të pa realizuara gjatë zbatimit të kontratës "Pastrim i zonës para rrjetave metalike tek vepra e marrjes në kuotë 222 mmnd dhe rrjetave të punës tek seksionet e tubacioneve të agregatit nr. 4 HEC Fierzë", vlerë e cila për Shoqërinë "Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare" dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

Brenda datës 31.08.2018

4. Gjetje nga auditimi: Gjatë zbatimit të kontratës së punimeve civile "Riparim i veshjes së betonit të digës në bjeftin e sipërm (kuota 280-296 mmnd)", janë çertifikuar punime të realizuara që kanë të bëjnë kryesisht me shkatërrimin e veshjes ekzistuese të amortizuar dhe vendosje skelerie në sasi dhe vlerë si më poshtë:

Përshkrimi i punimeve	Njësia	Çmimi lekë	Sasia në situacion përfundimtar	Sasia faktike	Diferenca lekë
		1	2	3	1 x (2 - 3)
Prishje strukture betoni	M ³	3,271	908.1	0	2,970,395
Transport me auto 5.0 km	"	372	908	0	337,813
Skelë shërbimi druri	"	1,523	426	0	648,798
Shuma:					3,957,006

Sa më sipër, vlera 4,748,407 lekë (3,957,006 lekë + TVSH) është përfitur padrejtësisht nga Kontraktori "N" sh.p.k dhe përbën dëm ekonomik.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, neni 7 (Trajtuar më hollësisht në faqet 40-115, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi:

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës 4,748,407 lekë, nga Shoqëria "N" Sh.p.k, për punime të likuiduara por të pa realizuara gjatë zbatimit të kontratës "Veshje e bjefit të sipërm të HEC Fierzë", vlerë e cila për Shoqërinë "Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare" dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik.**

Brenda datës 30.06.2018

5. Gjetje nga auditimi: Gjatë zbatimit të kontratës "Ndërtim i stacionit të furnizimit me karburant të automjeteve HEC Fierzë", janë situacionuar dhe likuiduar punime të pa realizuara që kanë të bëjnë me:

Nga verifikimi i punimeve të realizuara për zërin "Mure betoni C 12/15, rezulton se është likuiduar sasia 75.9 m³, ndërsa nga përlllogaritjet dhe verifikimi në terren rezulton se është realizuar sasia 54 m³, me një diferencë 21.9 m³. Në këtë zë punimi janë përfshirë punime shtresash dyshemeje (betonim para në dysheme në sasinë 11.4 m³ e cila është likuiduar edhe në zë tjetër punimi shtresash), themeli e mureve të gropës është llogaritur me lartësi 0.8 m, ndërkohë që kjo lartësi sipas projektit është 0.6 m.

Vlera 246,375 lekë (21.9 m³ x 9,375 lekë/m³ +20% TVSH), është përfituar padrejtësisht nga kontraktori "H" Sh.p.k dhe përbën dëm ekonomik.

Nga verifikimi i zërit "F.V Konstruksiione metalike të përbëra" rezulton se është likuiduar sasia 2.36 ton. Nga përlllogaritjet rezulton se është vendosur sasia 1.2 ton, me një diferencë 1.16 ton. Nga ana e kontraktorit nuk është detajuar në librezën e masave sasia e konstruksiioneve për mbulimin e karburantit. ***Vlera 192,456 lekë (1.16 ton x 138,259 lekë/ton + TVSH), është përfituar padrejtësisht nga kontraktori "H" Sh.p.k dhe përbën dëm ekonomik.***

Zëri i punimeve Soleta të plota është likuiduar në sasinë 7.5 m³ me çmim 14,018 lekë/m³. Nga krahasimi i projektit dhe verifikimi në vend rezulton se sasia e soletave të vendosura (për trashësi 10 cm sipas projektit) është 5.6 m³. Diferenca e soletës së pa realizuar është 1.9 m³ (7.5 m³ -5.6 m³). Trashësia e përfshirë në librezën e masave është 15 cm, ndërkohë që sipas projektit kjo trashësi është 12 cm, po ashtu sipërfaqja e përfshirë është me dimensione 10 x 5 m, ndërkohë që kjo sipërfaqe është 9 x 4.5 m. ***Vlera 32,877 lekë (1.9 m³ x 14,420 lekë/m³ + TVSH), është përfituar padrejtësisht nga kontraktori "H" Sh.p.k dhe përbën dëm ekonomik.***

Nga verifikimi i zërit "F.V Panele sanduiç" rezulton se është likuiduar sasia 37.5 m³, ndërkohë që nga verifikimi i punimeve është realizuar sasia 16 m², me një diferencë 21.5 m². Diferenca vjen për arsye se veshjet anësore dhe poshtë platformës janë realizuar me llamarinë të thjeshtë dhe jo panele sanduiç. ***Vlera 79,412 lekë (21.5 m² x 3,078 lekë/m² + TVSH), është përfituar padrejtësisht nga kontraktori "H" Sh.p.k dhe përbën dëm ekonomik.***

Nga verifikimi i zërit "F.V brez betoni c 16/20" rezulton se është përfshirë në librezën e masave sasia 3.4 m³ si shtresë (shtresë në kokën e rreshtit të parë të mureve gabion). Nga verifikimi i punimeve të realizuara rezulton se kjo shtresë nuk është realizuar. ***Vlera 50,673 lekë (3.4 m³ x 12,420 lekë/m³ + TVSH), është përfituar padrejtësisht nga kontraktori "H" Sh.p.k dhe përbën dëm ekonomik.***

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, neni 7.

Në total, nga Kontraktori "H" Sh.p.k, është përfituar padrejtësisht **vlera 601,793 lekë.** (Trajtuar më hollësisht në faqet 40-115, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi:

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 601,793 lekë**, nga Shoqëria "H" sh.p.k, për punime të likuiduara por të pa realizuara gjatë zbatimit të kontratës "Pastrim i zonës para rrjetave metalike tek vepra e marrjes në kuotë 222 mnnd dhe rrjetave të punës tek seksionet e tubacioneve të agregatit nr. 4 HEC Fierzë", vlerë e cila për Shoqërinë "Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare" dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

Brenda datës 30.06.2018

6. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni arkivor i vënë dispozicion u konstatua se "Privatizimi i magazinës Shkozet" i kryer nga Ministria e Financave dhe regjistrimi nga ZVRPP Durrës, është kryer jo vetëm në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, duke krijuar një dëm ekonomik për shoqërinë "KESH" SHA dhe Buxhetin e Shtetit **në vlerën 12,618,420 lekë**, por aktualisht kjo pasuri figuron e regjistruar si aset i KESH me vlerë kontabël 22,616,529.51 lekë, sipas vlerësimit të ekspertit kontabël miratuar me urdhrin nr. 544/1, datë 11.02.2015, të Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Theksojmë se në momentin e privatizimit dhe regjistrimit për llogari të personave të tretë kjo magazinë nga Shoqëria "KESH" SHA, i ishte dhënë me qira Shoqërisë "OSHEE" SHA. Pas vënies në dijeni nga korrespondenca shkresore midis OSHEE dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, i është drejtuar kësaj të fundit me shkresën nr. 1887/3 datë 07.12.2017, duke i kërkuar angazhimin e saj për verifikimin e rastit dhe trajtimin e problematikës trajtuar nga OSHEE me shkresën e saj nr. 21657/9 datë 08.11.2017. Grupit të auditimit deri në datën 31.01.2018, datë në cilën përfundoj auditimi, nuk i është vënë në dispozicion asnjë informacion zyrtar ose verbal në lidhje me këtë çështje (*Trajtuar më hollësisht në faqet 189-191, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi:

Nga Administratori i Shoqërisë të prezantohet në organet drejtuese **vlera 12,618,420 lekë**, që ka të bëjë me "Privatizimi i magazinës Shkozet" i kryer nga Ministria e Financave dhe regjistrimi nga ZVRPP Durrës, në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e Shoqërisë "KESH" SHA dhe Buxhetin e Shtetit.

Brenda datës 31.05.2018

B.2. DËM EKONOMIK PA MUNDËSI ARKËTIMI

B.2.1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të blerjes së energjisë elektrike për periudhën Prill-Dhjetor 2017, dhe krahasimi me shitjen e po të njëjtës sasi energjie në të njëjtën periudhë sipas muajve respektivë nga kompania "KESH" SHA tek operatorët privat të tregut të energjisë, vihet re një diferencë e madhe midis çmimit të shitjes së energjisë nga "KESH" SHA dhe çmimit të blerjes së energjisë nga "OSHEE" SHA, me një diferencë në vlerën 2,831,747 euro, e ardhur si rezultat i diferencës së madhe midis çmimit të shitjes së energjisë nga Shoqëria "KESH" SHA kompanive E, G, A, dhe G etj dhe çmimit të blerjes së energjisë nga Shoqëria "OSHEE" SHA nga këto kompani.

Shkaku;

a- më 31.01.2018, datë në të cilën ka përfunduar auditimi, nuk janë miratuar plotësisht (të gjitha) aktet nënligjore e rregullatore në zbatim të Ligjit 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike".

Miratimi dhe zbatimi sa më i shpejtë i gjitha akteve ligjore, nënligjore e rregullatore në zbatim të Ligjit 43/2015, do të bënte të mundur operimin e "KESH" SHA, në kushtet e një tregu konkurrues, duke mënjanuar kostot e panevojshme dhe duke rritur performancën financiare të

shoqërisë, jo vetëm për periudhën aktuale por edhe në vështrimin perspektiv në sektorin e energjisë elektrike (kemi parasysh këtu periudhën kur do të fillojë funksionimin Bursa Shqiptare e energjisë elektrike).

b- ERE me veprimet dhe mosveprimet e saj, ka krijuar problematikë serioze në zbatim të Ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe VKM nr. 244 datë 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik”, i ndryshuar, duke dëmtuar në këtë mënyrë interesat e ligjshme të shoqërisë “KESH” SHA, si dhe të Shtetit, pasi me vendimet e saj të deritanishme “Për miratimin e rregullave të tregut”, paraqet paqartësi dhe madje konflikt të vetë dispozitave të rregullave të tregut, të cilat nuk janë hartuar në frymën e Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nuk janë përshtatur me periudhën tranzitore, e cila do të sillte kalimin normal në rregullat përfundimtare miratuar sipas modelit të tregut, duke u shfaqur si rregulla në zbatim të parashikimeve të Ligjit të vjetër. Konkretisht: Vendimi i ERE nr. 111 datë 01.07.2016 “Mbi lënien në fuqi të Vendimeve nr. 139, nr. 141, nr. 145, nr. 146, nr. 147, nr. 148, datë 26.12.2014, Vendimi i ERE nr. 136, datë 15.08.2016 “Për miratimin e kontratës TIP për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga Shteti/KESH SHA dhe furnizuesit e shërbimit universal OSHEE SHA për periudhën 01.07.2016-31.12.2016”.

Edhe pse, përveç detyrimit ligjor në rolin e monitoruesit të shoqërive publike të tregut të energjisë, ERE ka përfituar nga Shoqëria “KESH” për periudhën 2014-2016, vlerën 101,406, 642 lekë, në zbatim të tarifave rregullatorë të vendosura çdo vit nga vetë ajo.

Deri në 31.01.2018, datë në të cilën përfundoj auditimi, nuk është hartuar dhe miratuar Rregullorja e re e procedurave të tregtimit të energjisë elektrike në zbatim të VKM nr. 729, datë 08.12.2017 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 122-189, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi:

-Nga Administratori i Shoqërisë të prezantohet në organet drejtuese **vlera 2,831,747 euro**, që përfaqëson diferencën midis çmimit të shitjes së energjisë në vlerat 11.11 deri në 61.14 euro nga “KESH” SHA tek operatorët privatë të tregut të energjisë (E, G, A, dhe G etj) dhe çmimit të blerjes së energjisë në vlerën 56.6 deri në 95.5 euro nga “OSHEE” SHA, pra këta operator energjinë e kanë blerë nga shteti shqiptar (Shoqëria “KESH” SHA dhe përsëri ja kanë shitur shtetit (Shoqërisë “OSHEE”) me çmim shumë herë më të lartë duke i krijuar një humbje të drejtpërdrejtë buxhetit të shtetit dhe në fund të fundit një detyrim financiar që e paguan konsumatori fundor shqiptar, vlerë e cila përbën dëmi ekonomik pa mundësi arkëtimi për Shoqërinë KESH SHA dhe për Buxhetin e Shtetit.

-Nga organet drejtuese të merren të gjitha masat për shqyrtimin dhe miratimin e Rregullores së re të procedurave të tregtimit të energjisë elektrike në zbatim të VKM nr. 729, datë 08.12.2017, duke marrë në konsideratë problematikat që kanë dalë gjatë zbatimit të rregulloreve të mëparshme.

Shënim: Pavarësisht faktit që në auditimet e mëparshme të KLSH-së, kjo gjetje është klasifikuar si e ardhur e munguar, nga ana jonë kjo gjetje do të riklasifikohet për të gjitha rastet e konstatuara si masë shpërblim dëmi ekonomik pa mundësi arkëtimi.

Brenda datës 31.05.2018

B.3. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

B.3.1. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, Shoqëria “KESH” SHA është penalizuar nga vendimet e gjykatave në vlerën 17,085,179 lekë.

Konkretisht ka 44 procese gjyqësore të hapura, ku është paditur nga ana e punonjësve të larguar për zgjidhje të marrëdhënieve të punës pa shkaqe të arsyeshme. Nga këto: 1 rast është në shkallë të parë të gjykimit, 16 janë në gjykatën e apelit, 3 raste janë rrëzuar nga gjykata e apelit dhe nuk është bërë ende rekursi për to dhe 24 raste janë për rekurs. Vlera totale e ekzekutuar deri në dhjetor 2017 është 17,085,179 lekë, nga të cilat 16,686,468 lekë për dëmshpërblime dhe shpenzime gjyqësore, dhe 398,711 lekë për shpenzime përmbartimore, vlerë e cila përbën efekt financiar negativ për buxhetin e Shoqërisë “KESH” SHA. Nga ana tjetër, kjo vlerë është ekzekutuar vetëm për 16 nga rastet e mësipërme ose 36.4% të rasteve totale në proces gjyqësor dhe pavarësisht ndjekjes në të gjitha shkallët e gjykimit dhe kontestimeve nga shoqëria të vendimeve të gjykatave, për dëmshpërblimet, si pasojë e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, konstatohet se vendimet janë në shumicën e rasteve në favor të punonjësve të larguar dhe në të ardhmen do të shkaktojnë rëndim të situatës financiare të shoqërisë, duke çenuar zhvillimin normal të aktivitetit ekonomik-financiar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 19-23, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi:

Nga Shoqëria “KESH” SHA të analizohen në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, si dhe krijimin e detyrimeve të shtuara përmbartimore, duke evidentuar përgjegjësitë individuale, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë, si dhe në të ardhmen të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

B.3.2. Gjetje nga auditimi: Nga nënshkrimi dhe zbatimi i marrëveshjes me shoqërinë “E”, në zbatim të:

-Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1363, datë 17.10.2008 “Për miratimin e marrëveshjes së koncesionit, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Shoqërisë “Ö”, për ndërtimin, pronësinë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të një hidrocentrali të ri në Ashtë, në Republikën e Shqipërisë botuar në fletoren zyrtare nr.163, datë 22.10.2008;

- Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë Elektrike (Off-Take Agreement), botuar në fletoren Zyrtare nr.163/1, datë 22.10.2008;

-Marrëveshjes për Koordinimin e Kaskadës mbi Lumin Drin (Cascade Cordination Agreement) botuar në fletoren Zyrtare nr.163/1, datë 22.10.2008;

- Marrëveshjes së Ndërlidhjes (Interconnection Agreement), datë 07.05.2013.

Është krijuar: Reduktim i kapacitetit energjetik për HEC Vau Dejës, për Shoqërinë “Korporatën Energjetike Shqiptare” SHA për periudhën Prill-Dhjetor 2017 në **sasinë 11,914 Mwh me vlerë 94,107,664 lekë ose 702,926 euro euro**, si dhe ka mosmarrëveshje ndërmjet Shoqërisë “KESH” SHA dhe Shoqërisë “E” SHA në lidhje me dëmshpërblimin e disbalancave të energjisë elektrike referuar Kontratës për Koordinimin e Kaskadës (CCA, e ardhur si pasojë e veprimeve dhe mos veprimet të ERE dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe

Energjisë për mos zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshje (Trajtuar më hollësisht në faqet 122-189, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi:

-Këshilli Mbikëqyrës, Administratori i Shoqërisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të marrin masa për kontraktuar një konsulent ligjor për zgjidhjen me mirëkuptim të mosmarrëveshjeve ndërmjet Shoqërisë “KESH” SHA dhe Shoqërisë “E” në lidhje me dëmshpërblimin e disbalancave të energjisë elektrike referuar Kontratës për Koordinimin e Kaskadës (CCA).

-Këshilli Mbikëqyrës, Administratori i Shoqërisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të marrin masa për të rinegociuar marrëveshjen me shoqërinë “E” me qëllimin e rikuperimit në vitet në vazhdim të vlerës prej të **94,107,664 lekë ose 702,926 euro**, si dhe shtimin e prodhimit të energjisë elektrike në Kaskadën e Drinit .

Brenda datës 30.06.2018

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, date 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, kontratës kolektive të punës nr. 3197 prot., datë 05.04.2016, kontratave individuale të punës, i kërkojmë Administratorit të Shoqërisë “KESH” SHA, marrjen/ose jo të masave disiplinore ndaj personelit, duke marrë në konsideratë shkeljet ligjore dhe përgjegjësiive respektive të cituar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të performancës së punës së tyre, si dhe të masave disiplinore të dhëna më parë në zbatim shkresës KESH nr. 277/3 prot, datë 24.01.2018 drejtuar Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, pasi për personelin e cituar në këtë Raport Përfundimtar të Auditimi janë dhënë njëherë masa disiplinore dhe nuk kanë kaluar as tre muaj nga dhënia e këtyre masave.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R